

Barometri politik 1/2009

Projekt afagjatë i hulumtimit të opinionit publik rreth gjendjes dhe ngjarjeve aktuale politike në Kosovë

Lulzim Pllana*

Përmbledhje

Me shfaqjen e një sistemi multipartiak në Kosovë, politika kosovare përkatësisht partitë apo personalitetet politike marrin orientime të ndryshme, çka bën që krijimi i një projekti të tillë të ndihmojë në vlerësimin e perceptimit të opinionit të publikut rreth këtyre orientimeve.

Barometri Politik synon të jetë pasqyrë dhe udhërrëfim i opinionit të publikut ndaj politikës dhe ngjarjeve aktuale në vend. Një realizim afatgjatë i projektit ngrit vetëdijen dhe nivelin e udhëheqjes politike dhe ngjall interesimin e opinionit për të gjykuar për aktualitet politikë në vend. Në këtë punim përfshihet një pjesë e rëndësishme e Barometrit Politik; pjesa tjetër do të publikohet në tërësi në broshurën që publikon Qendra jonë për Hulumtimin e Opinionit.

Fjalët kyç: *Hulumtim, Barometri Politik, Politika Kosovare, Demokracia, Gjendja materiale, Presidenti, Kryeministri, Parlamenti, Ministri, Partitë Politike, Zgjedhjet.*

Barometri politik është projekt hulumtues me tematikë politike i inicuar nga Universiteti AAB-RIINVEST, më saktësisht nga Qendra për Hulumtimin e Opinionit-QHO. Ky hulumtim i parë eksperimental financohet nga Universiteti AAB-RIINVEST dhe realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës, Qendrën për Hulumtimin e Opinionit Publik dhe të Komunikimit Masiv të këtij universiteti.¹

Në periudhën kohore prej 30-31 mars 2009, në bazë të pyetësorit të standardizuar dhe metodës „Face-to-face“, u

* Mr.sc. Lulzim Pllana, Universiteti AAB-Riinvest, Qendra për Hulumtim të Opinionit Publik-QHO. lulzim.pllana@universitetiaab.com

¹ www.cjm.si

zhvillua anketimi në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në zonat e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt, Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Mitrovicës, duke përfshirë këtu edhe vendbanimet me shumicë të nacionaliteteve të tjera. Shpërndarja e pyetësorëve është bërë sipas numrit të vendbanimeve të Entit të Statistikave të Kosovës.² Nga 880 persona të paraparë, janë përgjigjur 878 (99%) persona me të drejtë vote, çka e bën projektin reprezentativ. Anketimi nëpër komunat apo, më saktësisht, pikat anketuese, është kryer nga 30 anketues. Koha e plotësimit të një ankete ka zgjatur nga 5 deri në 10 minuta. Të dhënat janë analizuar me softuerin statistikor SPSS.³

Pyetësi është hartuar nga udhëheqësi i Qendrës Lulzim Pllana në bashkëpunim me prof. dr. Niko Tosh, udhëheqës i Qendrës për Hulumtimin e Opinioneve dhe Komunikimit Masiv në Lubjanë, dr. Slavko Kurdija, ligjërues në Universitetin e Lubjanës dhe bashkëpunëtor i qendrës.

Pyetësi përbehet nga pjesa fikse, që nënkupton të njëjtat pyetje në të gjitha fazat e anketimit, dhe pjesa e ndryshueshme, pyetje këto që kanë të bëjnë me situata dhe ngjarje aktuale përgjatë periudhës kohore të anketimit.

Pyetësi parasheh, në përgjithësi, përcaktimin dhe orientimin politik të opinionit publik rreth situatës politike, si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre dhe të ngjarjeve aktuale, sidomos të atyre politike, në Kosovë. Pas vlerësimit të besueshmërisë së institucioneve vendore, siç janë: Presidenti, Qeveria, Kryeministri, Parlamentit, Policia, partitë politike, KLMDNJ, Sindikatat dhe Ombudspersoni, ai ofron mundësinë e vlerësimit të institucioneve ndërkombëtare, siç janë: Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, po dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një vlerësim tjetër rreth besueshmërisë, është edhe ai i medieve, duke vlerësuar, kësaj radhe, vetëm ato visuele nacionale dhe lokale.

² Shih Enti të Statistikave të Kosovës www.ks-gov.net/esk.

³ Statistical Programme for Social Science.

Si pyetje më e rëndësishme e pjesës fikse të „Barometrit politik“ është e ashtuquajtura „pyetja e zgjedhjeve“ ose „ për cilën parti do të votoni“, që mund të konsiderohen si thelbi i tij. Me qëllim krahasimi të pozicioneve dhe përcaktimit të trendëve të partive politike, përfshihet në këtë punim edhe pozicioni i respondentëve nga barometri i mëhershëm⁴. Si rrjedhojë e kësaj nixirret edhe një vlerësim për personalitetet politike që janë në skenën aktuale politike kosovare si dhe që kanë kaluar prapë nga barometri i mëhershëm⁵. Kjo metodë e vlerësimit bën që vendimet e marra të personaliteteve politike të vlerësohen dhe të mund të elaborohen në bazë të aktiviteteve të tyre politike për një periudhë të gjatë. Ky vlerësim plotësohet më mirë duke parashtruar pyetjen rreth ndryshimit apo jo të gjendjes në çështjet sociale, ekonomike, arsimore, shëndetësore, të standardit jetësor, furnizimit me energji elektrike etj që nga zgjedhjet e fundit, të nëntorit të vitit 2007, domethënë.

Pjesën e ndryshueshme të barometrit e përbëjnë ato pyetje që mund apo nuk mund të përsëriten, varësisht nga situata aktuale, në pyetësorin e barometrit.


Në këtë punim jepen pjesë të përzgjedhura të barometrit politik, përderisa rezultatet complete mund të abonohen në Qendrën për Hulumtim të Opinioneve të Universitetit AAB-Rinvest.

Zhvillimi i demokracisë

Me zhvillimin i demokracisë në Kosovë duket që respondentët janë më të kënaqur se në fund të vitit të kaluar. Edhe pse gati gjysma nuk janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë, tendencat e rritjes shënojnë përmirësim. Nga 32% ka një rritje të kënaqësisë së zhvillimit të demokracisë në 43%, dhe një ulje të pakënaqësisë prej 58% në 46%.

⁴ Shih Lulzim Pllana, *Barometri Politik 1/2008*, Graph.9. f. 12. Dhjetor 2008.


⁵ Po aty.



Burimi: QHO n=878

Gjendja materiale


Me gjendjen materiale popullata në Kosovë duket të jetë e pakënaqur. Që të dy opsionet e përgjigjes tregojnë tendenca negative të rritjes. Nga 41% të kënaqur nga dhjetori i kaluar, në mars është ulur përqindja e tyre në 37%, kurse të pakënaqur, nga 55%, tashmë janë 57% e respondentëve. Siç shihet Kosova tashmë është prekur nga kriza globale financiare, shih. Graf. 13 dhe 14.



Burimi: QHO n=878

Përkrahja e qeverisë


Në krahasim me matjen e kaluar, duket se Qeveria e Kosovës sot ka një përkrahje diçka më të madhe. Numri që nuk e përkrah qeverinë është në rënie. Edhe numri i të pavendosurve është pak më i madh, çka do të thotë që mund të ndryshojnë mendimin e tyre në çdo kohë.



Burimi: QHO n=878

Besimi në Institucionet e Kosovës


Tek besimi në Institucionet e Kosovës kemi zhvillime të ndryshme. Presidenti hyn në garë të besueshmërisë për herë të parë dhe radhitet me një mesatare prej 3, përderisa vendin e parë e mban Policia, edhe pse me një rënie të vogël, duke u pasuar nga KLMDNJ dhe Kryeministri. Në krahasim me barometrin e dhjetorit, rritje më të madhe, përgjithësisht, kanë Sindikatat, KLMDNJ-ja, si dhe Kryeministri. Qeveria, Parlamenti dhe Ombudspersoni gati se nuk kanë lëvizur fare, kurse partitë politike kanë një tendencë të vogël rritjeje.



Burimi: QHO n=878

Besimi në Institucionet Ndërkombëtare

Në pyetjen se “Sa ju besoni Institucioneve Ndërkombëtare”, respondentët japin vlerësime të dallueshme mes këtyre institucioneve. Tek të gjitha kemi ngritje, veçanërisht tek Unioni Evropian (në Grafikon si EU) ku kemi ngritjen më të madhe. Prijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në Grafikon Nr.5 si USA) me një ngritje prej 4,27 në 4,33, Bashkimi Evropian prej 2,43 në 3,12, dhe Kombet e Bashkuara (në Grafikon si UN) 1,8 në 2,06.




Burimi: QHO n=878


Besimi në medie

Besimi në medie rezulton në këtë numër të barometrit me një rënie në krahasim me atë të dhjetorit të kaluar, edhe pse besimi vazhdon të jetë i madh. Nga afro 66% ulet në 62%. Rritet diçka edhe opinionin e atyre që nuk dinë nëse u besojnë apo jo, dmth. rritet nga 8% në 13%.

Në pyetjen pasuese, ndërkaq, se cilave medie televizive u besoni më shumë, nga respondentët del si rezultat që RTK prin me 40%, TV 21 me 19%, KTV me 18%, si dhe ato lokale me gjithsej 8%. Rreth 15% të të anketuarve nuk kishin opinion, çka do të thotë se një numër i krahasueshëm i të anketuarve ende nuk dinë se cilave medie televizive t'u besojnë.




Burimi: QHO n=878



Burimi: QHO n=878

Dalja në zgjedhje


Pyetjes: “Nëse do të mbaheshin zgjedhjet të dielën e ardhshme, a do të dilnit në zgjedhje?” respondentët japin një pasqyrë të qartë. Rreth 57% të anketuarve do të dilnin në zgjedhje, nëse do të mbaheshin, kurse 31% nuk do të dilnin. Rreth 12% e tyre nuk janë të vendosur nëse do të dilnin apo jo.



Burimi: QHO n=878

Votimi

Pyetja në vazhdim, se për cilën parti do të votonin të anketuarit nëse do të mbaheshin zgjedhjet dielën e ardhshme, siç shihet në grafikun vijues, jep rezultate të ndryshme. PDK prin me 23,8%, LDK me 13,9%, AAK me 10,6%, AKR 7,9%, Koalicioni LDD-PSHDK 5,0 %, PSD 3,9%, ORA 3,3% dhe PD me 2,7%. Numri i atyre që do të kishin zgjedhur një parti tjetër është 7,6%, kurse i atyre që nuk ishin ende të vendosur ishte dukshëm më i madh, me 21,3%.




Burimi: QHO n=878

Krahasimi i zgjedhjeve

Nëse i krahasojmë këto zgjedhje me ato të kaluarat, shihet se partitë politike kanë lëvizje të ndryshme, në shumicën e rasteve ulje të trendëve. Zakonisht kjo lëvizje mund të shpjegohet mbi bazën e sjelljeve të partive përballë publikut. PDK dhe LDK kanë nga një zbritje të vogël, AAK diçka më të dalluar, kurse AKR ka një ngritje nga të kaluarat. LDD-PSHDK nuk ka ndonjë ndryshim që vlen të theksohet. Vlen të përmendet edhe shfaqja e PSD-së në përgjithësi që arrin të ketë një trend në rritje. Numri i të pavendosurve, në krahasim me zgjedhjet e kaluara, është në

rënie, po prapë mbetet i madh, çka do të mund të ndryshonte situatën.




Burimi: QHO n=878

Personalitetet politike

Edhe personalitetet politike janë pjesë fikse e barometrit politik. Këtu respondentët janë lutur të japin personalitetin më të suksesshëm të politikës kosovare. Në prezantim janë përfshirë personalitetet që kanë kaluar pragun mbi 2,5% të përzgjedhur nga të anketuarit, shih graf. 11.

Nga rezultatet del se kryeministri Hashim Thaqi i prin listës së personaliteteve të suksesshme të Republikës së Kosovës, i pasuar nga Fatmir Sejdiu, president i Republikës, Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Një pasqyrë më të qartë e jep grafikoni në vijim.



Burimi: QHO n=878


Aktualitetet politike në vend

Sa i përket aktualiteteve politike në vend, barometri politik është koncentruar në çështjet që ishin të trajtuara nëpër mediet kosovare si: grevat e Sindikatave të Kosovës, kriza ekonomike, zvogëlimi i numrit të ushtarëve të KFOR-it, gjendja e përgjithshme e sigurisë në Kosovë, liria e lëvizjes për pakicat kombëtare, përkrahja për misionin e EULEX-it, normalizimi i marrëdhënieve Kosovë- Serbi, si dhe me një pyetje të veçantë rreth zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri.

Në vijim do të prezantohen vetëm ca nga këto tema, përderisa të tjerat do të botohen në broshurën complete të Qendrës për Hulumtim të Opinioneve.

Grevat e Sindikatave të Kosovës


Rreth grevave, respondentet japin një rezultat të qartë, sipas të cilit ata i përkrahin ato. Nga grafikoni shihet që rreth 67,2 % të anketuarve i përkrahin ato, kurse 18,4% nuk i përkrahin. Vetëm 14,8% nuk e kanë shprehur opinionin e tyre nëse i përkrahin ato apo jo.



Burimi: QHO n=878


Ndikimi i krizës globale ekonomike në Kosovë

Pyetjes nëse kriza globale në Kosovë do të ketë ndikim, respondentët përgjigjen që ajo do ta prekë edhe Kosovën. “Po” thonë 61,3%, ndërsa mendim të kundërt kanë 21,8%. Ata që nuk dinë janë vetëm 17%.



Burimi: QHO n=878

Ndërsa pyetjes nëse “e ka prekur kriza globale ekonomike familjen tuaj?”, gjysma e më shumë e respondentëve i përgjigjen se ajo tashmë i ka prekur familjet e tyre.




Burimi: QHO n=878

44,5% e të anketuarve tashmë e ndiejnë krizën ekonomike. “Pak” e ndiejnë vetëm 14%, ndërsa një numër i konsiderueshëm, rreth 41,5% ende nuk e kane ndier atë.

Siguria e përgjithshme në Kosovë


Me gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Kosovë, të anketuarit janë të kënaqur në shumicën e rasteve. 57,9% pohojnë se janë të kënaqur, 30,5% nuk janë të kënaqur, kurse 11,6% prej tyre nuk e dinë se si ta vlerësojnë gjendjen e sigurisë.



Burimi: QHO n=878

Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri

Respondentët kosovarë kanë një qëndrim të qarte rreth zgjedhjeve parlamentare të sivjetme në Shqipëri. Respondentët kishin një pyetje, të ashtuquajtur, të mbyllur, se kush do t'i fitojë zgjedhjet parlamentare në Shqipëri në qershorin e këtij viti.



Burimi: QHO n=878

Shumica shprehen që Sali Berisha, Partia Demokratike, do t'i fitojnë zgjedhjet parlamentare në Shqipëri. Për Edi Ramën apo Partinë Socialiste, shprehen 15,3%. Për parti të tjera janë 3,3%, kurse nuk dinë 24,1% të respondentëve kosovarë.

Përfundim

Barometri Politik 2 jep një pasqyrë të qartë të vlerësimit të aktiviteteve politike në periudhën kohore prej mars-prill 2009. Pos tjerash, ai mundëson edhe krahasimin e rrugës së politikës kosovare me atë të dhjetorit të vitit të kaluar, në ca raste edhe të zgjedhjeve të fundit të vitit 2007. Veçanërisht përcjell edhe evenimentet apo aktualitetet politike që ndodhin në territorin e Republikës së Kosovës. Me këtë publikim apo publikime të mëtutjeshme, Barometri synon të bëhet zë i opinionit publik përballë politikave aktuale të vendit.